



103.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 5704 prot.

Vlorë, më 24.03 2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____. 2026

PËR

MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DALJA
E LUMIT VJOSA, NË DATË 08.01.2026 NË BANESAT E QYTETARËVE DHE
SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2; neni 9/1 pika b; neni 29/1; neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, Urdhërit të brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Nr.20 datë 09.01.2026 për ngritjen e grupeve të punës, pasi u mor në shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë.

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara në banesa nga dalja e lumit Vjosa, në datë 08.01.2026 për familjet e dëmtuara sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

- Baldazar Nanxa	208.740 lekë
- Haxhi Myrteli	336.414 lekë
- Robert Moçka	363.904 + (98,289x50%=49,144) total 413,048 lekë
- Rajmonda Moçka	305,969 lekë
- Erjon Moçka	249,664 lekë
- Hamit Bitaj	377,360 + (78,632x50%=39,316) total 416,676 lekë
- Valbona Bitaj	460,293 + (98,289x50%=49,144) total 509,437 lekë
- Pijazit Shehu	435,664 lekë
- Roland Hamzo	259,237 lekë
- Lulëzim Hamzo	249,009 lekë
- Eleni Myrteli	262,343 lekë
- Agron Mersinaj	233,104 lekë
- Festim Mersinaj	336,237 lekë
- Ilam Tojalli	17,800 lekë
- Luan Bulla	48,269 lekë
- Arjan Tojalli	43,000 lekë
- Azbi Çepele	77,269 lekë

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika 6.

KRYETAR
Brunilda Mersini






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 5704 prot.

Vlorë, më 24.03 2026

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DALJA E LUMIT VJOSA, NË DATË 08.01.2026 NË BANESAT E QYTETARËVE DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË”

Në zbatim të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Komisioni i Bashkisë Vlorë, i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.20, datë 09.01.2026 “Për ngritjen e grupeve të vlerësimit për konstatimin e gjendjes në banesat e përmbytura nga dalja e lumit Vjosa në Njësinë Administrative Novoselë”.

Me ngritjen e grupit të punës dhe kërkesave të banorëve të zonës u bë konstatimi në terren i dëmeve të shkaktuara nga dalja e lumit Vjosa. U konsatua se 17 familje kishin dëmtime në banesa dhe orendi shtëpiake.

Mbas hartimit të procesverbaleve të konstatimit të gjendjes në banesat e dëmtuara të datës 08.01.2026.

Me shkresë nr.3301 prot. datë, 17.02.2026, “Dërgohet dokumentacioni për banesat e dëmtuara” në Këshillin e Qarkut për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën nr.3301/1 prot. datë, 23.12.2024, “Dërgim dokumentacioni për banesat e dëmtuara nga dalja e lumit Vjosa” ka dërguar preventivat e hartuar nga komisioni i ekspertëve të qarkut.

Vlera e dëmeve në banesat e dëmtuara të datës 08.01.2026 është 4,401,880 (katër milion e katërqind e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.

Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

